

DRAFT

**RREGULLORE PËR UNIFORMAT DHE PERDORIMIN E TYRE NGA
INSPEKTORËT NË KOMUNËN E GJAKOVËS**

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton llojet dhe dukjen e uniformave të inspektorëve në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
2. Përcaktimi i kodit të veshjes së inspektorëve do të kontribuojë në efikasitetin e punës, ngritjes së performancës, transparencës, dinjitetit dhe imazhit të inspektoratit e cila ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve në punën e inspektorëve.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore janë të detyrueshme për të gjithë inspektorët në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Komuna: Komuna e Gjakovës, siç është paraparë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
2. DPI: Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
3. Inspektor: Inspektori në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
4. Rregullore: Rregullorja për uniformat dhe përdorimin e tyre nga inspektorët në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës.
5. Uniforma: Veshmbathjet, e qe përfshinë: Pantallona/fund, xhemper/pouluver, rrip, sako, këmishë, pallto/mont, këpucë, jelek.

Neni 4

Obligimi i inspektorëve

1. Të gjithë inspektorët në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese, gjatë orarit të punës janë të obliguar të bartin uniformën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Inspektorët duhet t'i mbajnë uniformat në mënyrë të rregullt të mbërthyer, të pastërta, të hekurosur për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin dhe të mos i keqpërdorin ato.
3. Gjatë mbajtjes së uniformës, inspektorët nuk duhet t'i mbajnë duart në xhepa, ndërsa mirëmbajtja e flokëve, fytyrës dhe pamja e përgjithshme duhet të jetë në përputhje me kodin e etikes.

4. Gjatë përdorimit të uniformes, inspektorëve të gjinisë mashkullore i ndalohet mbajtja e atleteve/patikave, mbajtja e qaforeve dhe vathëve, kurse lejohet mbajtja e orës dhe një unazë me madhësi normale, ndërsa për inspektorët e gjinisë femërore, i ndalohet mbajtja e atleteve/patikave, mbajtja e qaforeve në mënyrë të dukshme, kurse madhësia e stolive të tjera (vathë, unaza, orë, zinxhirë dore), duhet të jenë normale.
5. Ndalohet përdorimi i uniformes jashtë orarit zyrtar të punës, me përjashtim të punëve të autorizuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe nga shtëpia në punë dhe anasjelltas.

Neni 5

Dizajni

1. Dizajni i uniformave duhet të jetë i përafërt si për inspektorët burra ashtu edhe për inspektorët gra.
2. Uniforma duhet të dallohen sipas sezonit, në ato verore dhe dimërore.
3. Gjatë sezonit veror, uniforma do të mbahet nga data 1 maj deri më 30 shtator.
4. Gjatë sezonit dimëror, uniforma do të mbahet nga data 1 tetor deri më 30 prill.

Neni 6

Uniforma verore

1. Uniforma verore do të duket si në vijim:
 - 1.1. Pantollona (burrat), pantallona/fund (gratë) me ngjyrë të kaltër të mbylltë;
 - 1.2. Rrip pantallonash, ngjyre e zeze për gratë dhe burrat;
 - 1.3. Këmishë të bardhë me mëngë të shkurtra për gratë dhe burrat;
 - 1.4. Sako me ngjyrë të kaltër të mbylltë për gratë dhe burrat;
 - 1.5. Këpucë të verës me ngjyrë të zezë për gratë dhe burrat;
 - 1.6. Jelek me ngjyre të zeze.

Neni 7

Uniforma dimërore

1. Uniformat dimërore do të duken si në vijim:
 - 1.1. Pantallona (burrat), pantallona/fund (gratë) të dimrit me ngjyrë të kaltër të mbylltë;
 - 1.2. Rrip pantallonash, ngjyre e zeze për gratë dhe burrat;
 - 1.3. Xhemper/pulovër të dimrit me ngjyrë të zeze për gratë dhe burrat;
 - 1.4. Këmishë të bardhë me mëngë të gjata për gratë dhe burrat;
 - 1.5. Sako të dimrit me ngjyrë të kaltër të mbylltë për gratë dhe burrat;
 - 1.6. Pallto/mont dimri të gjatë me ngjyrë të zezë për gratë dhe burrat;
 - 1.7. Këpucë dimri të thella me ngjyrë të zezë për gratë dhe burrat;
 - 1.8. Jelek me ngjyre të zeze.

Neni 8

Simbolet

1. Simbolet shtetërore (Flamuri i Republikës së Kosovës), duhet të jetë i ngjitur në uniformë (në sako) në krahun e djathtë.
2. Simbolet e Komunës së Gjakovës me mbishkrimin e inspektoratit (varësisht prej inspektoratit), duhet të jenë të i ngjitur në uniformë (në sako) në krahun e majtë.
3. Kartela identifikuese (ID) duhet të jetë e ekspozuar në pjesën e përparme të trupit apo e lidhur rreth qafës.
4. Madhësia e simboleve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jetë e madhësisë 6 cm gjerësi dhe 6 cm gjatësi.
5. Jeleku duhet të ketë mbishkrimin në pjesën e prapme (në shpine) e shënuar INSPEKTORATI (varësisht prej llojit) si dhe në pjesën e përparme në të majte e shënuar INSPEKTORATI (varësisht prej llojit) si dhe simbolet shtetërore (Flamuri i Republikës së Kosovës) i cili duhet të jetë në fillim të tekstit, ndërsa simboli i Komunës së Gjakovës duhet të jete në fund të tekstit.
6. Teksti i shënuar INSPEKTORATI në pjesën e përparme duhet të jete deri në 3 cm, ndërsa teksti i shënuar INSPEKTORATI në pjesën e prapme (varësisht prej llojit), duhet të jetë së paku 5 cm.

Neni 9

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj rregullore

1. Mbikëqyrjen zbatimin e kësaj rregulloreje e bën udhëheqësi me i larte administrativ i Komunës së Gjakovës.
2. Për udhëheqësit e sektorit në kuadër të DPI-së është përgjegjës drejtori i DPI-së, ndërsa për inspektorët është përgjegjës udhëheqësi i sektorit në kuadër të DPI-së.
3. Udhëheqësi i sektorit mund të autorizoj inspektorin që për dite apo inspektime të caktuara të veshin jelekun apo kompletin (pantallonat, këmbishën, sakon).
4. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i inspektorit ka përgjegjësi të kontrollojë nëse zbatohen dispozitat e kësaj rregullore dhe mund të shqiptoi vërejtje me shkrim nëse inspektori shkel dispozitat e kësaj rregullore, e për shkeljet e përsëritura të kësaj rregullore përbejnë shkak për inicim të procedurës disiplinore.

Neni 10

Furnizimi me uniformë

1. Furnizimi me uniforma duhet të bëhet me kohë dhe në mënyrë të rregullt, sipas nevojës së inspektorëve, minimumi një here në vite.
2. Furnizimi me uniforma do të bëhet përmes procedurave të prokurimit publik.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Gjakovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Anton Shala